

Në bazë të nenit 55, paragrafit (1) të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19, 110/19 dhe 121/24) dhe neni 102, paragrafi (1) të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 06/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 229/20 dhe 78/25), ministria e Arsimit dhe Shkencës përcaktoi:

UDHËZUES
për numrin e nevojshëm të punonjësve
në shkollat e mesme publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 1

Ky Udhëzues përcakton numrin e nevojshëm të punonjësve në shkollat e mesme publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 2

Për përcaktimin e numrit të nevojshëm të mësimitdhënësve në shkollat e mesme publike, si kriter merren planet dhe programet mësimore, gjegjësisht numrin e orëve mësimore edhe atë:

- orët teorike të mësimitdhënies, të cilat përfshijnë edhe aktivitete projektuese dhe përmbajtjet e programuara nga shkolla: nga 20 orë deri më 23 orë në javë;
- orët mësimore për mësimitdhënie praktike dhe ushtrime në shkollë: nga 26 orë në 28 orë në javë;
- orët mësimore për mësimitdhënie praktike jashtë shkollës: nga 34 orë deri më 36 orë në javë;
- orët mësimore për të mësuarit përmes punës tek punëdhënësi në kompani reale shkollore: nga 26 orë deri më 28 orë në javë;
- orët mësimore për të mësuarit përmes punës tek punëdhënësi në kompani: nga 34 orë deri më 36 orë në javë;
- orët mësimore - korepeticion: 60 orë në javë;
- orët mësimore - korepeticion në ritëm: 36 orë në javë;
- orët mësimore - korr: 4 orë në javë dhe
- orët mësimore - orkestër: 4 orë në javë.

Orët mësimore në korr, orkestër, aktivitete projektuese dhe përmbajtje programuese nga shkolla, u ndahen mësimitdhënësve të cilët kanë krijuar marrëdhënie pune me kohë të pacaktuara, gjegjësisht të cilët pjesërisht ose plotësisht kanë mbetur pa orë mësimore në shkollë.

Neni 3

Në çdo shkollë të mesme publike do të ketë 1 (një) drejtor me kohë të plotë.

Në çdo qendër rajonale për arsim profesional dhe trajnim do të ketë 1 (një) drejtor me kohë të plotë dhe 5 (pesë) udhëheqës.

Udhëheqësit e qendrave rajonale mund të angazhohen me së shumti deri me gjysmën e kohës së punës pas pëlqimit të marrë paraprak nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në çdo shkollë të mesme publike ju takojnë bashkëpunëtorë profesional të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Mësimdhënësit dhe Bashkëpunëtorët Profesionalë në Shkollat Filllore dhe të Mesme.

Për përcaktimin e numrit të nevojshëm të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e mesme publike, si kriter merret numri i nxënësve në shkollë edhe atë:

- deri në 500 nxënës, më së shumti 3 (tre) bashkëpunëtorë profesional;
- deri në 1000 nxënës, më së shumti 5 (pesë) bashkëpunëtorë profesional; dhe
- mbi 1000 nxënës, më së shumti 7 (shtatë) bashkëpunëtorë profesional.

Çdo shkollë të mesme publike ju takon nëpunës administrativë dhe ofrues të shërbimeve publike të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit për Arsimin e Mesëm.

Për përcaktimin e numrit të nevojshëm të nëpunësve administrativë në shkollat e mesme publike si kriter merret numri i nxënësve në shkollë edhe atë:

- deri në 500 nxënës, më së shumti 3 (tre) nëpunës administrativë;
- deri në 1000 nxënës, më së shumti 4 (katër) nëpunës administrativë; dhe
- mbi 1000 nxënës, më së shumti 6 (gjashtë) nëpunës administrativë.

Në përputhje me programet mësimore të lëndëve të caktuara mësimore, në shkollat e mesme publike ju takon edhe bashkëpunëtorë profesional të mësimit praktik (laborantë).

Për përcaktimin e numrit të nevojshëm të bashkëpunëtorëve profesional për mësimin praktik (laborantë) në shkollat e mesme publike, si kriter merret numri i paraleleve për kualifikim, gjegjësisht sektorit ku janë parashikuar në programet mësimore sipas lëndëve mësimore të caktuara edhe atë:

- nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) paralele, më së shumti 1 (një) laborant;
- nga 11 (njëmbëdhjetë) deri në 16 (gjashtëmbëdhjetë) paralele, më së shumti 2 (dy) laborantë;
- nga 17 (shtatëmbëdhjetë) deri në 22 (njëzet e dy) paralele, më së shumti 3 (tre) laborantë;
- mbi 22 (njëzet e dy) paralele, më së shumti 5 (pesë) laborantë.

Neni 4

Çdo shkollë e mesme publike e cila ka bibliotekë me deri në 5,000 tituj të fondit të librave ju takon gjysma e kohës së punës - bashkëpunëtor profesional (bibliotekar).

Çdo shkollë e mesme publike e cila ka bibliotekë me mbi 5,000 tituj të fondit të librave ju takon një vend pune - bashkëpunëtorë profesional (bibliotekar).

Neni 5

Çdo shkollë të mesme publike ju takon vend pune për mirëmbajtje të vazhdueshme të objekteve, ndërsa në shkollat e mesme publike të cilat janë të kyçura me ngrohje qendrore ju takojnë deri në dy vende pune për mirëmbajtje të vazhdueshme të objekteve.

Për sigurinë fizike të objekteve në shkollën e mesme publike, ju takojnë deri në dy vende pune - rojtar.

Për mirëmbajtjen e higjienës, në shkollat e mesme publike ju takojnë higjienistë sipas hapsirës me të cilën disponon shkolla dhe punës me ndërrime:

sipërfaqja në m2 për person për punë në:	
Një ndërrim	Dy ndërrime
700 m ²	600 m ²

Numri i vendeve të punës për higjienistë merret kur sipërfaqja e përgjithshme pjesëtohet me normativin në m2.

Neni 6

Punonjësit ekzistues me kohë të pacaktuar (kuadri administrativ dhe teknik dhe bashkëpunëtorët profesionalë për mësimdhënien praktike) do të vazhdojnë marrëdhënien e tyre të punës të themeluar në shkollat e mesme publike.

Nuk lejohet punësimi i bashkëpunëtorëve profesionalë për mësimdhënien praktike (laborantë) në bazë të financimit të ri.

Neni 7

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij Udhëzuesi, pushon së vlefshmi Kriteret për përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve në veprimtarin e arsimit të mesëm me prot. numrin 11-6303/1 të datës 09.10.2003.

Neni 8

Ky Udhëzues hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së sjelljes së tij, ndërsa do të fillojnë të aplikohet prej më 01.09.2025.

**Министерка за образование и наука/
Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска**

Numër 13-8306/1
16.6.2025
Shkup